

APAB

Abschlussprüferaufsichtsbehörde



**Parimet Themelore për Rregullatorët e Auditimit
– shembulli Austriak
Vjenë, 1 dhjetor 2022**

Punëtorja e Komunitetit të Praktikës CFRR

Michael Komarek, Drejtor Ekzekutiv

1. Përgjegjësitë, organizimi dhe financimi

Parimi 1:

“Përgjegjësitë dhe kompetencat e rregullatorëve të auditimit duhet t'i shërbejnë interesit publik dhe të deklarohen qartë dhe objektivisht në legjislacion”

Parimi 2:

“Rregullatorët e auditimit duhet të jenë të pavarur”

Parimi 4:



“Rregullatorët e auditimit duhet të kenë kompetenca rregullatore gjithëpërfshirëse për të promovuar auditime me cilësi të lartë”

Parimi 5:

“Rregullatorët e auditimit duhet të kenë burime dhe staf të mjaftueshëm me kompetencë dhe ekspertizë përkatëse, të cilët janë të pavarur nga profesioni”

1. Përgjegjësitë, organizimi dhe financimi

1.1 Krijimi dhe kuadri ligjor

- Autoriteti Austriak Mbikëqyrës i Auditimit (APAB) është themeluar në vitin 2016 si organ kompetent kombëtar për mbikëqyrjen e auditimit.
- Autoriteti vepron i **pavarur dhe i lirë nga udhëzimet** nën mbikëqyrjen ligjore të Ministrisë Federale të Financave.
- Kuadri ligjor:
 - Direktiva 2006/43/EG, Rregullorja (BE) Nr. 537/2014
 -  Akti mbi Mbikëqyrjen e Audituesit (APAG)
 -  Akti Austriak i Biznesit (UGB, 3. Libri mbi Pasqyrat Financiare dhe Kontabilitetin)
 - si dhe të gjitha dispozitat në lidhje me auditimet e Aktit Austriak Bankar (BWG), Aktit Austriak Mbikëqyrës i Sigurimeve (VAG), Aktit Austriak të Kooperativës (GenG) dhe Aktit Austriak të Auditimit të Bashkëpunimit (GenRevG), Aktit Austriak të Bankës së Kursimeve (SpG), Akti i Bursës (BörseG),...
- Fushëveprimi është i kufizuar në auditimin ligjor → shërbimet e tjera të sigurimit janë jashtë fushëveprimit

1. Përgjegjësitë, organizimi dhe financimi


1.2 Katalogu i detyrave

- Inspektime me firmat e auditimit të entiteteve me interes publik (EIP)
- Rishikime të Sigurimit të Cilësisë për auditorët ligjorë dhe firmat e auditimit
- Regjistrimi i auditorëve ligjorë dhe firmave të auditimit
- Hetimet e auditorëve ligjorë, firmave të auditimit ose EIP-ve
- Vendosja e sanksioneve në rast të shkeljeve të Ligjit për Mbikëqyrjen e Auditimit, Rregullorja (BE) Nr. 537/2014
- Miratimi i standardeve për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe standardet e auditimit
- Monitorimi i respektimit të detyrimeve të trajnimit të auditorëve ligjorë
- Mbikëqyrja e cilësisë dhe konkurrencës në tregun e auditimit për EIP

1. Përgjegjësitë, organizimi dhe financimi

1.3 Struktura organizative


Mbikëqyrja ligjore nga Ministria Federale e Financave



1. Përgjegjësitë, organizimi dhe financimi

1.4 Financimi

Buxheti i APAB për vitin 2022 është 1,7 milion EUR. Kontributet e auditorëve të EIP dhe profesionit janë të detyrueshme dhe të përcaktuara në bazë ligjore



2. Pavarësia dhe konfidencialiteti i rregullatorit

Parimi 6:

"Rregullatorët e auditimit duhet të jenë objektivë, të lirë nga konfliktet e interesit dhe të mbajnë marrëveshjet e duhura të konfidencialitetit"

2. Pavarësia dhe konfidencialiteti i rregullatorit

2.1 Pavarësia

Pavarësia nga profesioni

- Periudhat e “ftohjes”:
 - Drejtorët ekzekutivë dhe anëtarët e bordit mbikëqyrës duhet të jenë të pavarur nga profesioni për të paktën tre vjet
 - Inspektorëve u ndalohet të inspektojnë ish-punëdhënësit e tyre për të paktën tre vjet
- Financimi i autoritetit nga subjektet e mbikëqyrura bazohet në detyrime ligjore
- Anëtarët e këshillit mbikëqyrës emërohen nga Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë
- Drejtorët ekzekutivë emërohen nga kabineti i ministrave në bazë të rekomandimit të bordit mbikëqyrës

2. Pavarësia dhe konfidencialiteti i rregullatorit

2.2 Konfidencialiteti

Konfidencialiteti

- Të gjithë punonjësit e APAB i nënshtohen dhe obligohen ng sekreti zyrtar austriak për nëpunësit civilë
- Shkelja e detyrimeve të fshehtësisë zyrtare është një vepër penale e sanksionuar me maksimum 3 vjet burg.

→ Problemi: APAB nuk mund të ndan informacione me autoritetet e tjera kombëtare (p.sh. Autoriteti i Tregjeve Financiare) përveç nëse ekziston një dispozitë e qartë ligjore që e lejon atë

2. Sigurimi i cilësisë

Parimi 8:

"Rregullatorët e auditimit duhet të kryejnë së paku inspektime të përsëritura të firmave të auditimit që kryejnë auditime të subjekteve me interes publik"

Parimi 9:

"Rregullatorët e auditimit duhet të sigurohen se ekziston një program inspektimi i bazuar në rrezik"

Parimi 10:

"Rregullatorët e auditimit duhet të sigurojnë që inspektimet përfshijnë procedura efektive si për shqyrtimin e dosjeve të angazhimit të auditimit në të gjithë firmën"

Parimi 11:

"Rregullatorët e auditimit duhet të kenë një mekanizëm për raportimin e gjetjeve të inspektimit tek firma e auditimit dhe adresimin e korigjimit të gjetjeve me firmën e auditimit"

2. Sigurimi i cilësisë

2.1. Sigurimi dhe Regjistrimi i Cilësisë

- Për të kryer auditime ligjore në Austri kërkohet një licencë e kufizuar në kohë
- Regjistrimi në **regjistrin publik** zakonisht lidhet me një përfundim të suksesshëm të një rishikimi të sigurimit të cilësisë
- Pas përfundimit të suksesshëm të një rishikimi të sigurimit të cilësisë, audituesi ose firma e auditimit marrin një licencë të kufizuar në kohë deri në 6 vjet
- Nëse identifikohen mangësi, licenca mund të refuzohet ose kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës mund të reduktohet.
- Pranimet e reja ose ripranimet e auditorëve: licencë e përkohshme e kufizuar në 18 muaj

2. Sigurimi i cilësisë

2.2. Rishikimet e Sigurimit të Cilësisë kundrejt Inspektiveve

Rishikimet e Sigurimit të Cilësisë

- Të gjithë auditorët ligjorë i nënshtrohen rishikimeve të sigurimit të cilësisë
- Këto kryhen nga praktikues të cilët janë të regjistruar si rishikues të sigurimit të cilësisë në APAB
- Rishikuesit e sigurimit të cilësisë përzgjidhen nga APAB
- vlerësohen nga Komisioni i Rishikimit të Sigurimit të Cilësisë i cili bën rekomandime
- APAB vendos nëse rishikimi është përfunduar me sukses dhe për periudhën e vlefshmërisë së licencës (maksimumi 6 vjet)

Inspektimet

- Firmat e auditimit që auditojnë EIP-të (entitetet e listuara, bankat dhe kompanitë e sigurimit) i nënshtrohen inspektimit
- Inspektimet kryhen të paktën çdo 3 vjet, për firmat Big-4 çdo 1 deri në 2 vjet
- Inspektimet kryhen nga vetë inspektorët e APAB-së – ndonjëherë të mbështetur nga ekspertë të jashtëm
- Që nga 30 shtatori 2022 janë 14 firma të auditimit të EIP.

2. Sigurimi i cilësisë

2.3. Qasja e inspektimit

- I gjithë procesi bazohet në manualin e qasjes së inspektimit të APAB
- APAB përdor Metodologjinë e Përbashkët të Inspektimit të Auditimit (CAIM) të *Komitetit të Organeve Evropiane të Mbikëqyrjes së Auditimit* → CAIM është publikuar në faqen e internetit të CEAOB
- Inspektimet përfshijnë rishikime të firmave dhe dosjeve
- Testet dhe hapat e inspektimit dokumentohen me përdorimin e një vegje softuerike (Pentana)
- Koha e shpenzuar për çdo inspektim: ndërmjet 5-12 javë pune FTE për rishikim të firmës dhe ndërmjet 1-3 javë pune FTE për çdo rishikim skedari
- Gjetjet komunikohen dhe diskutohen me firmën e auditimit përpara se të finalizohet një raport inspektimi

2. Sigurimi i cilësisë

2.4. Përmirësimi

- Nëse identifikohen mangësi në inspektime ose rishikime të sigurimit të cilësisë, APAB mund t'i japë auditorit ose firmës së auditimit një urdhër administrativ për të korrigjuar mangësitë brenda një periudhe të arsyeshme kohore (zakonisht 9 muaj).
- Auditori ligjor duhet t'i provojë ndreqjen APAB-së
- Në rast të mospërputhjes së vazhdueshme me masat e vendosura që rezultojnë nga rishikimet e sigurimit të cilësisë, APAB mund të tërheqë licencën

3. Hetimet dhe zbatimi

Parimi 12:

"Rregullatorët e auditimit duhet të kenë kompetenca të pavarura hetimore përballë auditorëve dhe firmave të auditimit nën juridiksionin e tyre"

Parimi 13:

"Rregullatorët e auditimit duhet të kenë në dispozicion një gamë gjithëpërfshirëse dhe me ndikim të masave/sanksioneve disiplinore kundër auditorëve dhe firmave të auditimit"

Parimi 14:

"Rregullatorët e auditimit duhet të kenë autoritetin për të komunikuar masat/sanksionet disiplinore për publikun"

3. Hetimet dhe zbatimi

3.1. Hetimet

- APAB mund të kryejë hetime të auditorëve dhe PIE për të identifikuar shkelje të mundshme të detyrimeve ligjore në lidhje me auditimet
- Hetimet mund të fillojnë me urdhër procedural në çdo kohë
- APAB mund të përdorë ekspertë të jashtëm
- Kostot e hetimit i ngarkohen auditorit të hetuar ose PIE, pavarësisht nga rezultati

3. Hetimet dhe zbatimi

3.2. Kompetencat e Sanksioneve

- Urdhërimi i një personi fizik ose juridik përgjegjës për një shkelje që të ndalojë sjelljen që çon në shkelje dhe të përmbahet në të ardhmen nga përsëritja e ndonjë sjelljeje të tillë
- Deklaratë publike për natyrën e shkeljes, e cila do të publikohet në faqen e internetit të APAB-së → megjithatë: pa zbuluar të dhëna personale
- Ndalimi i kryerjes dhe/nënshkrimit të auditimeve ligjore deri në 3 vjet për audituesin ligjor, firmën e auditimit ose auditorin përgjegjës
- Ndalimi i përkohshëm i ekzekutimit të rolit deri në 3 vjet për anëtarët e firmave të auditimit ose anëtarët e një organi administrativ ose drejtues të EIP
- Vendosja e gjobave financiare nga 400 euro deri në 350 000 euro
- Tërheqja e licencës

➤ Nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm për një vepër penale, APAB duhet t'ia referojë çështjen Shërbimit të Prokurorisë Publike.

4. Transparenca dhe bashkëpunimi

Parimi 3:

“Rregullatorët e auditimit duhet të jenë transparent dhe të përgjegjshëm. Ata duhet të kenë një kuptim të mirë të nevojave të palëve të tyre të interesit dhe të tregut të auditimit në juridiksionin e tyre”

Parimi 7:

“Rregullatorët e auditimit duhet të bëjnë marrëveshjet e duhura për bashkëpunim me rregullatorë të tjerë të auditimit dhe, kur është e nevojshme, me autoritete të tjera kombëtare”

4. Transparenca dhe bashkëpunimi

4.1. Transparenca

APAB publikon:

- Programi vjetor i punës
- Raport vjetor mbi aktivitetet e APAB i cili përfshin edhe të dhëna statistikore për tregun e auditimit
- Buxheti vjetor dhe pasqyrat financiare
- Raporti vjetor i Qeverisjes së Korporatës
- Raportet mbi aktivitetet mbikëqyrëse (p.sh. raporte të publikuara në vitin 2022: Raport mbi kulturën e auditimit; Raport mbi aktivitetet e komiteteve të auditimit)

4. Transparenca dhe bashkëpunimi

4.2. Bashkëpunimi

Bashkëpunimi ndërkombëtar

- APAB është një anëtar aktiv i IFIAR dhe CEAOB
- APAB kryeson Grupin Punues të Investitorëve dhe Palëve të tjera të Interesit të IFIAR
- Bashkëpunimi me autoritetet e Shteteve Anëtare të BE-së nëpërmjet CEAOB
- Bashkëpunimi me vendet e treta: MM dhe Marrëveshja për Mbrojtjen e të Dhënave me PCAOB (SHBA), MiM me CPAB (Kanada) dhe RAB (Zvicër); APAB ka kryer inspektime të përbashkëta me PCAOB dhe CPAB

Bashkëpunimi kombëtar

- Bashkëpunim intensiv me Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë për tema të ndryshme, p.sh.
 - Standardet e Auditimit
 - Zbatimi i kontabilitetit
 - Përshtatshmëria e auditorëve të bankave dhe sigurimeve
 - Dialog me komitetet e auditimit
- Bashkëpunimi me Dhomën e Kontabilistëve Publikë, Shërbimin e Prokurorisë Publike, Panelin Përmbarues të Raportimit Financiar dhe autoritete të tjera kombëtare

© 2022 Austrian Audit Oversight Authority. All rights reserved. In this document APAB refers to the Austrian Audit Oversight Authority which is an authority acting independently and free from instructions under legal supervision of the Federal Ministry of Finance. The information in this document is of a mere general nature and not necessarily comprehensive, complete, precise or up-to-date. It further does not represent professional or legal advice of any kind. The information contained is legally not binding.